



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Patos, më ____ .07.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

23.07.2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE): “2 AT” shpk, me NUIS K14019001H, me adresë: Korce - Dishnice, Nje magazine me sip 2987 m2, ne Bare(Barç) Korce, Zona kadastrale 1101, numër pasurie 262/82, volumi11, faqe 5. 7001.

Tipi i Kontratës: Kontratë furnizimi

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: REF-90588-06-19-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje acid klorhidrik”, do te levrohen jo me vone se 30 ditë nga lidhja e kontrates.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 22.06.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Nr.41 datë 29 Qershor 2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kane marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “2 AT” shpk me NUIS K14019001H ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 2,626,404 lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk me NUIS M11815028I ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 2,626,404 lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “ATLANTIK 3” shpk me NUIS K22218003V ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 2,387,640 lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik “CHIMICA-AL” shpk me NUIS M31703048H ka ofruar për këtë tender vlerën ekonomike në total 2,268,258 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

- Operatori Ekonomik “ATLANTIK 3” shpk me NUIS K22218003V nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit, konkretisht:
 - OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per artikujt objekt prokurimi. Autorizimi i paraqitur nga OE nuk lidhet me objektin e procedurës (acid klorhidrik) së prokurimit por është për produkte detergjentë, kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.2. të pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës 8 të DST-së.
 - OE nuk ka paraqitur katalog/skede teknike nga prodhuesi per artikujt objekt prokurimi. Katalogu i paraqitur nga OE është për produkte detergjentë, kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës 8 të DST-së
- Operatori Ekonomik “CHIMICA-AL” shpk me NUIS M31703048H nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit, konkretisht:
 - OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per artikujt objekt prokurimi. Autorizimi i paraqitur nga OE është nga distributori dhe nuk provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit, kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.2. të pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës 8 të DST-së.
 - OE nuk ka paraqitur katalog/skede teknike nga prodhuesi per artikujt objekt prokurimi. Katalogu i paraqitur nga OE është nga distributori, kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës 8 të DST-së.
- Në datë 21.07.2026, ora 11:00 pranë Albpetrol sha, në prani të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Perfagesuesve te Operatoreve ekonomik “2 AT” shpk me NUIS K14019001H dhe “Albania Distribution Chemicals” shpk me NUIS M11815028I, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje acid klorhidrik” me numër reference REF-90588-06-19-2026, u krye procesi i hedhjes së shortit duke qene se të dy OE: “2 AT” shpk, me NUIS K14019001H dhe “Albania Distribution Chemicals” shpk me NUIS M11815028I kanë paraqitur ofertë të njëjtë ekonomike në vlerën 2,626,404 (dy milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e katër) lekë pa TVSH. Pas hedhjes se shortit rezultoi renditja si më poshtë:

Në vend të parë

Operatori Ekonomik “2 AT” shpk

Në vend të dytë

Operatori Ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk

Duke iu referuar procedures së lartpërmendur, informojmë OE: “2 AT” shpk, me NUIS K14019001H, me adresë: Korce - Dishnice, Nje magazine me sip 2987 m2, ne Bare(Barç) Korce, Zona kadastrale 1101, numër pasurie 262/82, volumi11, faqe 5. 7001, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 2,626,404 (dy milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Eltar DEDA